



BASHKIA TIRANË SI KATALIZATORE E FORCAVE INTEGRUESE NË BE BRENDË SHOQËRISË SHQIPTARE

Procesi i integritimit është një proces i cili nuk mundet të përfshijë vetëm profesionistët që janë ngarkuar me detyrën e kontekstualizimit të acquis, por një proces i cili duhet të gjenerojë forca nga e gjithë shoqëria. Fundja, është Shqipëria si e tërë ajo që do të integrohet, jo vetëm administrata. Për të arritur gjenerimin e forcave integruese brenda shoqërisë, Bashkia Tiranë mund të shërbejë si katalizator duke kultivuar aktivizim, edukim politik, dhe debat.

Aktivizmi konsiston në përpjekjet për të nxitur, drejtuar dhe ndërhyrë në reforma shoqërore. Ky është një përkufizim i përgjithshëm, i cili e shkëput aktivizimin nga monopoli i politikës, dhe e fut në konturet e politik-bërjes. Politika përfshin mekanizmat e marrjes së pushtetit, ndërsa politik-bërja definohet nga mënyra si ky pushtet vihet në shërbim të shoqërisë. Në këtë sens, aktivizmi si politik-bërje shprehet edhe tek një individ që nuk pranon të blejë tek kioskat ilegale, por bën pazaret tek tregjet e bashkisë, për të mbështetur komunitetin lokal taksapagues.

Një element i rëndësishëm i politik-bërjes është lidhja e saj me aktivizimin. Të dyja këto procese kanë për qëllim përmirësimin e realitetit nëpërmjet veprimesh të paramenduara. Dhe në këtë qëllim, ato përplotësojnë tërësisht njëra-tjetrën. Kjo sepse politik-bërja kryen hapin e parë drejt qëllimit, atë të të menduarit dhe planifikuarit. Aktivizmi, shërben si muskuli që vepron për të realizuar atë që është planifikuar.

Aktivizmi është gjithmonë ndërpersonal, pasi e ardhmja që synon të realizojë i përket komunitetit, të tërë. Ndaj aktivizmi është gjithmonë rrjedhojë e një shumëllojshmërie idesh që burojnë nga një shumëllojshmëri individësh. Që kjo re mendimesh të shndërrohet në një rezultante të vetme, debati është i domosdoshëm. Debati si përplasje idesh, një përplasje që i zhvesh idetë nga çka është jo e domosdoshme, dhe i bashkon ato në një rezultate që avancon për lart. Si rrjedhojë pra, politik-bërja, aktivizmi dhe debati janë elementë kryesorë të një shoqërie, e si të tillë, ata janë komponentë të domosdoshëm dhe të proceseve integruese, sikurse përthithja e *acquis*.

Si një ndër institucionet më të rëndësishme të Shqipërisë, dhe si aktori më i rëndësishëm i qeverive vendore, Bashkia Tiranë mund të ndërmarrë dy hapa të rëndësishëm të cilat mund të nxisin një debat të shëndetshëm që fuqizon aktivizimin dhe politikat integruese në nivel lokal.

Së pari, Bashkia e Tiranës duhet të nisë një fushatë gjithëpërfshirëse të synuar për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të nxitur debat mbi procesin e integritit të Shqipërisë në BE brenda institucioneve arsimore. Kjo fushatë do të synonte si shkollat e mesme ashtu edhe universitetet, duke integruar aspekte kyçe të *acquis* të BE-së—arsimimi, kultura, mjedisi dhe punësimi—në kurikulum dhe aktivitete jashtëkurrikulare. Bashkia mund të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit për të zhvilluar një modul kurikulumi mbi integrimin në BE. Bashkia, me ndihmën e organizatave lokale jo qeveritare, gjithashtu mund të krijojë klube debati që fokusohen në diskutimin e aspekteve të ndryshme të *acquis*. Këto klube mund të organizojnë debate, 'speak events', apo konkurse eseje nga ku vet Bashkia mund të përfitojë ide inovative se si të përshpetojë *acquis*. Qeveria vendore gjithashtu mund të organizojë workshop-e dhe seminare të udhëhequra nga ekspertë. Këto seanca jo vetëm që do të edukojnë studentët, por gjithashtu do të ofrojnë një platformë ndërveprimi.

Së dyti, Bashkia e Tiranës mund të krijojë një seri 'forumesh komunitare për politik-bërje', të dizajnuara për të angazhuar qytetarët në diskutime mbi procesin e integritit të Shqipërisë në BE, me një fokus të veçantë në mënyrën se si do të ndikojë në çështjet lokale të lidhura me arsimimin, kulturën, mjedisin dhe punësimin. Këto forume mund të organizohen në nivel lagjeje dhe do të synojnë të bashkojnë grupe të ndryshme qytetarësh, duke përfshirë profesionistë, studentë, aktivistë të mjedisit, praktika kulturore dhe pronarë biznesesh lokalë.



Në terma praktikë, autoritetet lokale mund të organizojnë forume mujore në lagje të ndryshme në Tiranë, secili duke u përqendruar në një komponent specifik të acquis. Për shembull, një forum mund të fokusohet në acquis mjedisor, duke diskutuar se si rregulloret e BE-së mbi menaxhimin e mbetjeve, cilësinë e ajrit dhe biodiversitetin mund të ndikojnë në komunitetet lokale. Një tjetër mund të fokusohet në punësim, duke eksploruar se si standardet e punës të BE-së dhe mundësitë për punë ndërkufitare mund të përfitojnë banorët lokalë.

Me këto iniciativa, Bashkia e Tiranës mund të rrisë në mënyrë të ndjeshme angazhimin publik në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Këto iniciativa do të fuqizojnë qytetarët e Tiranës dhe do të sigurojnë që komuniteti lokal të luajë një rol aktiv në formësimin e së ardhmes së qytetit në përputhje me standardet e BE-së. Përmes debatit të informuar, workshop-eve bashkëpunuese dhe dialogut të vazhdueshëm, Tirana mund të nxisë një ambient më përfshirës që mund të shërbejë si shembull dhe në vendet që ndodhen që tani në Bashkimin Evropian.